REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr.818 Prot Tiranë, më 26/4/2023

# REKOMANDIM

**Nr.21, datë 26/4/2023**

**PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS SË AUTORITETIT PUBLIK AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

Në mbështetje të neneve 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*", shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale",* i ndryshuar*,*

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare: https://www.ascal.al/sq/, të Autoritetit Publik/Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (në vijim "Autoriteti Publik").

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (në vijim "LDI"), kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike e këtij informacioni.

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: "*Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi...*".



Adresa: "Rr. Abdi Toptani, Nd.5 Tirane". Telefon:00355 42237200 www.idp.al info@idp.al

Në zbatim të gërmës “c”, pika 2 e nenit 4, nenit 5 dhe 6 të LDI, Zyra e Komisionerit ka miratuar Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” i ndryshuar.
Ky program, vlerësohet si një mënyrë përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të tij me informacion dhe dokumentacion publik.

Autoriteti Publik ka detyrimin të vendosë në zbatim programin institucional të transparencës, sipas Urdhrit nr.187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.

Nisur nga rëndësia që paraqet arsimi, Zyra e Komisionerit ka vendosur në fokus të punës së saj për vitin 2023, monitorimin e transparencës proaktive të Autoriteteve Publike në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, Drejtoria e Monitorimin të Programeve të Transparencës pranë Zyrës së Komisionerit, kreu monitorimin on-line të faqes zyrtare të Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të rishikuar të transparencës.

Nga monitorimi i kryer në menunë e faqes zyrtare https://www.ascal.al/sq/programi-i-transparences/programi-transparences, Autoriteti Publik ka publikuar “Programin e Transparencës”. Specifikisht, është publikuar informacion mbi strukturën, organigramën, funksionet dhe detyrat, CV e drejtuesit të Autoritetit Publik, por jo e ndërlidhur me Programin e Transparencës, pagat e nëpunësve subjekt deklarimi, legjislacion kombëtar, akte nënligjore, rregullore, raporte vjetore, koordinatori për të drejtën e informimit, (emër/mbiemër, e-mail, adresa, orari), raporte monitorimi/auditimi, raport vjetor mbi zbatimin e buxhetit, regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, raporte, publikime, statistika, si dhe projekte dhe bashkëpunime, të cilat nuk janë ndërlidhur me programin e transparencës.

Bazuar në monitorimin e kryer, Zyra e Komisionerit konstaton mosvënien në zbatim të Programit të Transparencës, në përputhje me pikën 1 të nenit 7 të LDI, urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar të Komisionerit.

Zyra e komisionerit konstaton se një pjesë e detyrimeve është publikuar edhe në faqen zyrtare, por nga ana tjetër vërejmë se ky informacion nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës së Autoritetit Publik, si dhe nuk është përditësuar.

Konkretisht rezultojnë mangësi në rubrikat e mëposhtme:

**Rreth autoritetit:**

- Struktura e pagave

- CV-të dhe pagat e nënpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të AP, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre dhe procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime.

**Kuadri ligjor rregullator**
- Legjislacion ndërkombëtar
- Kodi i sjelljes
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit
- Strategji
- Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e AP dhe që prek publikun.

**Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP**
- Rezolutë Kuvendi
- Planet strategjike të punës
- Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës

**Informacion mbi buxhetin dhe të dhëna financiare të autoritetit publik**
- Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara
- Donacione, sponsorizime (sipas viteve)
- Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara

**Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncensionit/partneritetit publik privat**
- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik i ASCAL
- Informacion mbi monitorimin e kontratave
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik i ASCAL i përditësuar

**Shërbimet që ofrohen nga AP**
- Tarifat përkatëse
- Afati kohor
- Formular aplikimi
- Standartet për cilësinë e shërbimit

**Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP**
- Emër mbiemër koordinatori për konsultimin me publikun, adresë postare /elektronike

**Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve**
- Lista e dokumenteve që administrohen nga PP me afatet e ruajtjes



Adresa: "Rr. Abdi Toptani, Nd.5 Tirane". Telefon:00355 42237200 www.idp.al info@idp.al

- Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)

**Informacion/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun**

- Njoftime të ndryshme
- Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimit në shërbim civil
- Projekte dhe bashkëpunimet janë publikuar, por nuk janë të ndërlidhura me programin e transparencës.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pavarësisht se një pjesë e informacionit publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet t'i përmbahet informacionit sipas Programit të Transparencës të Rishikuar miratuar me urdhrin nr.187, datë 18.12.2020, "Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar", të ndryshuar, sipas gjetjeve të pasqyruara në lidhjen nr. 1 të këtij rekomandimi.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Nga ana tjetër, Programi Model i Transparencës përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës së autoriteteve publike dhe çdo autoritet është i detyruar ligjërisht t`a zbatojë atë.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*", shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale",* i ndryshuar, nga monitorimi i kryer,

**REKOMANDOJ :**

1. Autoriteti Publik, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), në zbatim të gërmave a), b) dhe c), të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të përditësojë, ndërlidhë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Urdhrin nr.187, datë 18.12.2020, "Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar", të ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas lidhjes nr. 1 të këtij rekomandimi.

2. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, "*Institucionet publike dhe private bashkëpunojnë me Komisionerin, duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave, si dhe e njoftojnë atë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar për kryerjen e tyre*", të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni.



Adresa: "Rr. Abdi Toptani, Nd.5 Tirane". Telefon:00355 42237200 www.idp.al info@idp.al

3. Në zbatim të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, pas përfundimit të afatit të mësipërm, Komisioneri do të nisë hetimin administrativ.

4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 26.4.2023.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**



Adresa: “Rr. Abdi Toptani, Nd.5 Tirane”. Telefon:00355 42237200 www.idp.al info@idp.al

**Lidhja nr.1**

Raport i monitorimit për zbatimin e programit institucional të transparencës, bazuar në Urdhërin nr. 187 datë 18.12.2020 "Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar", të Komisionerit për të Drejtën e Infomimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për Autoritetin Publik/ **Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL)**

**Prill 2023**

| |
|---|
| Ky raport monitorimi merr në konsideratë vetëm publikimin e informacioneve të cilat janë të ndërlidhura me programin e transparencës sipas Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 "Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar". |

| | | |
|---|---|---|
| 1 | **Rreth Autoritetit** | |
| | Struktura organizative/Organigrama | Po |
| | Struktura e pagave | Jo |
| | Funksionet dhe detyrat e AP | Po |
| | CV-të dhe pagat e nënpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të AP, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre dhe procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime. | CV e drejtorit, por jo ndërlidhur në PT |
| | Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e AP ( Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve | Jo |
| 2 | **Kuadri ligjor rregullator** | |
| | Legjislacion ndërkombëtar | Jo |
| | Legjislacion kombëtar | Po |
| | Akte nënligjore | Po |
| | Rregullore | Po |
| | Kodi i sjelljes | Jo |

| | | |
|---|---|---|
| | Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit | Jo |
| | Strategji | Jo |
| | Raport vjetor | Po |
| | Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e AP dhe që prek publikun | Jo |
| 3 | **E drejta për tu informuar** | |
| | Koordinatori / Emri mbiemri | Po |
| | E-mail | Po |
| | Nr. i gjelbër | Jo |
| | Tel: | Po |
| | Adresa: | Po |
| | Orari: | Po |
| | Format kërkese / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim) | Po |
| | Format ankese / Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisioneri) | Jo |
| 4 | **Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP** | |
| | Rezolute Kuvendi | Jo |
| | Planet strategjike të punës | Jo |
| | Raporte monitorimi/auditimi KLSH | Po |
| | Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës | Jo |
| 5 | **Informacion mbi buxhetin dhe të dhëna financiare të autoritetit publik** | |
| | Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara (sipas viteve) | Jo 2022, 2023 |
| | Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset (sipas viteve) | Po |
| | Donacione, sponsorizime (sipas viteve) | Jo |
| | Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara | Jo |
| 6 | **Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncensionit/partneritetit publik privat** | |

| | | |
|---|---|---|
| | Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve) | Po |
| | Regjistri i realizimeve të prokurimit publik | Jo 2022, 2023 |
| | Informacion mbi monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme | Jo |
| | Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik i përditësuar | Jo 2022, 2023 |
| 7 | **Shërbimet që ofrohen nga AP**<br>Tarifat përkatëse | Jo |
| | Formular aplikimi | Jo |
| | Afati kohor | Jo |
| | Procedura aplikimi | Jo |
| | Standartet për cilësinë e shërbimit | Jo |
| 8 | **Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP** | AP nuk ka iniciativë për propozimin e akteve ligjore. |
| | Njoftimi dhe konsultimi publik (Linku) | - |
| | Komente/Rekomandime/Opinione të palëve të interesuara/grupe interesi | - |
| | Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve | - |
| | Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes | - |
| | Procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP | - |
| | Emër mbiemër koordinatori për konsultimin me publikun, adresë postare /elektronike | Jo |
| 9 | **Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve** | |
| | Lista e dokumenteve që administrohen nga PP me afatet e ruajtjes | Jo |
| | Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto) | Jo |
| 10 | **Rregjistri i kërkesave dhe Përgjigjeve** | |
| | Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar (sipas Modelit të Regjistrit të miratuar nga Komisioneri) | Po |

| | | |
|---|---|---|
| | Kërkesat dhe përgjigjet (të linkuara për AP që nuk kanë instaluar portalin Pyet Shtetin/Portali Pyet Shtetin i përditësuar me kërkesat dhe përgjigjet) | Jo |
| 11 | **Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP** | AP nuk e ofron këtë shërbim |
| | Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP | - |
| | Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve | - |
| | Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim | - |
| | Procedura e ankimimit | - |
| 12 | **Informacion/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun** | |
| | Njoftime të ndryshme | Jo |
| | Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimit në shërbim civil | Jo |
| | Raporte | Po |
| | Publikime | Po |
| | Statistika | Po |
| | Projekte | Po, por nuk i ndërlidh në PT |
| | Bashkëpunime etj. | Po, por nuk i ndërlidh në PT |

Programi i Transparencës ASCAL × Struktura dhe Njësitë × +
ascal.al/sq/rreth-nesh/struktura-dhe-njesite
IDP | Official Website



## Rreth Nesh

Misioni dhe Veprimtaria
Drejtori
Struktura dhe Njësitë
Administrimi
- Financat
Legjislacioni
Projekte
Marrëveshje Bashkëpunimi
e-ASCAL

## Struktura dhe Njësitë

Miratuar me **Urdhër Nr.20, datë 26.01.2021** "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë"



**Drejtor i Përgjithshem**

Dr. Xhiliola Bixheku

**Sektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë**

Përgjegjës Sektori

Specialistët

- Majlinda Demirneli majlinda.demirneli@ascal.al
- Arjana Alija arjana.alija@ascal.al
- Endra Velaj endra.velaj@ascal.al
- Anilda Beqiraj anilda.beqiraj@ascal.al
- Rajna Lila rajna.lila@ascal.al
- Alma Arapi alma.arapi@ascal.al

Activate Windows
Type here to search
56°F Cloudy 10:34 AM 3/27/2023

Programi i Transparencës ASCAL

ascal.al/sq/programi-i-transparences/programi-transparences

IDP | Official Website

KREU | RRETH NESH | BORDI I AKREDITIMIT | AKREDITIMI | SIGURIMI I CILËSISË | SONDAZHI KOMBËTAR STUDENTËVE | INFORMACIONE

| | | |
|---|---|---|
| Rreth autoritetit | Kuadri ligjor rregullator<br>Tekstet e plota | E drejta për t'u informuar dhe për tu ankuar |
| Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi ASCAL | Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të ASCAL | Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat |
| Shërbimet që ofrohen nga ASCAL | Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të ASCAL | Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve |
| Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve | Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga ASCAL | Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga ASCAL |

- Struktura organizative/Organigrama
- Struktura e pagave
- Funksionet dhe detyrat e ASCAL
- CV-të dhe pagat e nëpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit.
- Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të ASCAL për të marrë vendime
- Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e ASCAL (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve)

back to top ↑

Partnerët | Kalendari i Veprimtarisë | Kontakte

AFFILIATE OF ENQA

March 2023

Mon Tue Wed Thu Fri Sat Sun

ascal

Activate Windows
Go to Settings to activate Windows.

Type here to search

56°F Cloudy

10:34 AM
3/27/2023

## Rreth Nesh

- Misioni dhe Veprimtaria
- Drejtori
- Struktura dhe Njësitë
- Administrimi
  - Financat
- Legjislacioni
- Projekte
- Marrëveshje Bashkëpunimi
- e-ASCAL

# Misioni dhe Veprimtaria

Agjencia e Sigurimit te Cilësise në Arsimin e Lartë është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 109, date 15.02.2017 / english version ( i ndryshuar me vendim Nr. 825, datë 24.12.2021 dhe Vendim nr. 562, datë 31.07.2019 / english version), nga riorganizimi i Agjencisë Publike të Arsimit të Lartë e cila është krijuar me vendim të Këshillit te Ministrave nr. 303, datë 01.07.1999 dhe në mbështetje të ligjit nr 80/2015, për arsimin e larte dhe kërkimin shkencor

ASCAL është i vetmi institucion në RSh qe kontrollon dhe vlerëson cilësinë në arsimin e lartë. Kjo, duke u mbeshtetur në standardet shtetërore të cilësisë dhe në standardet dhe udhezimet perkatëse të cilësisë në Hapësirën Europiane dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë. ASCAL është i pavarur, i paanshëm dhe transparent në kryerjen e veprimtarisë se tij. ASCAL kryen vlerësimin paraprak të cilësisë për IAL-të, njësitë e tyre dhe programet e studimit të të tre cikleve në kuadër të licencimit të tyre si dhe vlerësimin e jashtëm në kuadër te akreditimit institucional dhe të programeve të studimit. Gjithashtu Agjencia kryen vleresime analitike dhe krahasuese për IAL, programet dhe fushat e studimit.

**Misioni i ASCAL**

- Sigurimi i cilesise ne arsimin e lartë permes vlerësimit të jashtëm, objektiv dhe të pavarur
- Ruajtja e standardeve të cilësisë
- Promovimi dhe përmirësimi i cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë e të programeve të studimit që ato ofrojnë

**Veprimtaria e ASCAL**

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë për akreditimin e parë dhe periodik të institucioneve të arsimit te lartë e të programeve te studimit që ato ofrojne;
Monitorimi, vlerësimi i cilësisë akademike dhe i përputhshmërise me standardet e cilesisë se institucioneve dhe programeve te ofruara prej tyre, përpara vlerësimit për akreditim të pare dhe ne vijim;
Vlerësimi paraprak në kuadër të hapjes dhe/ose riorganizimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit me kërkesë të ministrisë përgjegjese për arsimin;
Vlerësimi paraprak dhe njohja e programeve të studimit, të ofruara në institucionet shqiptare të akredituara të arsimit të lartë nga institucione te huaja te arsimit te larte të njërit prej shteteve të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara te Amerikës, Kanadase dhe Australisë;
Vlerësimi periodik, çdo tre vjet, i cilësisë së mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë dhe monitorimi i vazhdueshëm i tij përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve, ne përputhje me udhëzuesit e saj;
Vlerësimi i sistemeve të brendshme të cilësisë (auditimi) në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me udhëzuesit e saj dhe standardet e udhëzimet për sigurimin e cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të larte;
Vleresime tematike, analitike dhe krahasuese të institucioneve dhe/ose programeve të studimit, në funksion te politikave për arsimin e lartë, në mënyrë autonome ose me kërkesë te ministrisë përgjegjese për arsimin

Type here to search  56°F Cloudy  10:34 AM 3/27/2023

# Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë



## Rreth Nesh

- Misioni dhe Vestimtaria
- Drejtori
- Struktura dhe Njësitë
- Administrimi
  - Financat
- Legjislacioni
- Projekte
- Marrëveshje Bashkëpunimi
- e-ASCAL

## Drejtori



**Znj. Xhilliola Bixheku** ka përfunduar studimet e larta universitare "Bachelor" në "Biologji", si dhe "Master i shkencave" në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale" në Universitetin e Tiranës. Po ashtu Znj. Bixheku ka përfunduar studimet e ciklit të tretë "Doktoratë" duke zotëruar gradën shkencore "Doktor" në "Shkencat e Prodhimit Shtazor" të përfunduar në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Znj. Bixheku ka një përvojë të pasur profesionale në fushën e arsimit të lartë, duke filluar që prej muajit Janar të vitit 2016 e në vazhdim si pjesë e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ku prej datës 8 Mars 2021 ka mbajtur edhe pozicionin e drejtorit të komanduar të ASCAL.

Znj. Bixheku më herët ka punuar në pozicionin e biologes, pranë një laboratori mjekësor. Në kuadër të zhvillimit të studimeve të saj të doktoratës ka qenë e angazhuar në mësimdhënie në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), ku në vitin akademik 2021 – 2022 ka qenë e angazhuar edhe si pedagoge e ftuar.

Znj. Bixheku, si pjesë e stafit të ASCAL, ka qenë e angazhuar në shumë procese vlerësimi të jashtëm në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit të ofruara prej tyre, përfshirë këtu akreditimin institucional me Agjencinë Britanike QAA, ka qenë pjesë e sekretariatit të Bordit të Akreditimit prej muajit tetor të vitit 2016, ka koordinuar procesin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS) të zhvilluar në periudhën Mars – Qershor 2022, ka përfaqësuar ASCAL në projekte e aktivitete të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare, ka kontribuar si hartuese e standardeve të cilësisë në arsimin e lartë, ka qenë pjesë e një sërë grupesh pune, si për hartimin e projektligjit "Për Shkencën", hartimin e Projekt Strategjisë së Shkencës dhe Inovacionit, rankimin e institucioneve të arsimit të lartë, etj.

Znj. Bixheku është autore dhe bashkëautore e disa artikujve shkencorë, të publikuar brenda dhe jashtë vendit.

back to top ↑

Activate Windows
Type here to search 56°F Cloudy 10:36 AM 3/27/2023

Programi i Transparences ASCAL

ascal.al/sq/programi-i-transparences/programi-transparences

IDF | Official Website

KREU RRETH NESH BORDI I AKREDITIMIT AKREDITIMI SIGURIMI I CILËSISË SONDAZHI KOMBËTAR STUDENTËVE INFORMACIONE

Lartë

| | | |
|---|---|---|
| Rreth autoritetit | Kuadri ligjor rregullator Tekstet e plota | E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar |
| Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi ASCAL | Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të ASCAL | Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat |
| Shërbimet që ofrohen nga ASCAL | Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të ASCAL | Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve |
| Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve | Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga ASCAL | Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga ASCAL |

- Legjislacion kombëtar
- Akte nënligjore
- Rregullore
- Raport vjetor
- Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e ASCAL dhe që prek publikun

Back to top

Partnerët

AFFILIATE OF ENQA

Kalendari i Veprimtarisë

March 2023

Mon Tue Wed Thu Fri Sat Sun

Kontakte

ascal

Activate Windows

Type here to search

56°F Cloudy 10:37 AM 3/27/2023

## Rreth Nesh



# Legjislacioni mbi ASCAL

**Ligje**

1. Ligji Nr 80/2015, Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
2. Ligji Nr. 9741, datë 21.05.2007, Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë - i ndryshuar (me ligjet Nr. 9832, datë 12.11.2007, Nr. 10307, datë 22.07.2010, Nr. 10493, datë 15.12.2011)

**Urdhëra të Kryeministrit**

1. Urdhër Nr. 4, datë 17.01.2023, Për emërimin në detyrë të drejtorit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
2. Urdhër Nr. 41, datë 08.02.2019, Për lirimin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
3. Urdhër Nr. 44, datë 11.04.2017, Për emërimin në detyrë të drejtorit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë

**Vendime dhe Urdhëra të Këshillit të Ministrave**

1. Vendim i KM nr. 824, datë 24.12.2021, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë
2. Vendim i KM nr. 825, datë 24.12.2021, " Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 109, datë 15.2.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", të ndryshuar"
3. Vendim i KM nr. 621, datë 22.10.2021, "Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj"
4. Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026
5. Vendim i KM nr. 185, datë 25.3.2021, Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar
6. Vendim i KM nr. 879, datë 18.12.2019, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të këshillit të ministrave,

Activate Windows
Type here to search 56°F Cloudy 10:38 AM 3/27/2023

ndryshim në vendimin nr 424, datë 02.06.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", të ndryshuar"

12. Vendim i KM nr. 359, datë 24.04.2013, Për një ndryshim në vendimin nr. 424, datë 02.06.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", të ndryshuar (shfuqizuar)
13. Vendim i KM nr. 101, datë 06.02.2013, Për një shtesë në vendimin nr. 424, datë 02.06.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", të ndryshuar
14. Vendim i KM nr. 368, datë 14.04.2011, Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 424, datë 02.06.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", të ndryshuar
15. Urdhër i KM nr. 171, datë 27.09.2010, Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë
16. Vendim i KM nr. 424, datë 02.06.2010, Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të cilësisë
17. Vendim i KM nr. 1509, datë 30.07.2008, Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin e Lartë, 2008 - 2013
18. Vendim i KM nr. 303, datë 01.07.1999, Për krijimin e Sistemit të Akredimit në Arsimin e Lartë

**Urdhëra dhe Udhëzime të Ministrit përgjegjës për Arsimin**

1. Urdhër i MAS nr. 43/1, datë 24.02.2014, Për emërim të përkohshëm në detyrë
2. Urdhër i MAS nr. 43, datë 21.02.2014, Për lirim dhe emërim në detyrë
3. Udhëzim i përbashkët i MASh dhe MINFIN nr. 7, datë 08.03.2013, Për një ndryshim dhe shtesë në udhëzimin nr. 29/1, datë 16.08.2011 "Për përcaktimin e tarifave dhe shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë"
4. Udhëzim i përbashkët i MASh dhe MINFIN nr. 29/1, datë 16.08.2011, Për përcaktimin e e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë
5. Udhëzim i përbashkët i MASh dhe MINFIN nr. 29, datë 04.08.2011, Për përcaktimin e e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë
6. Udhëzim i përbashkët i MASh dhe MINFIN nr. 2, datë 18.01.2011, Për përcaktimin e tarifave dhe shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë
7. Urdhër i MASh nr. 408, datë 10.08.2010, Për lirimin dhe emërimin në detyrë
8. Udhëzim i MASh nr. 4, datë 28.02.2006, Për përcaktimin e tarifave të vlerësimit dhe akreditimit për shkollat e larta jopublike

Activate Windows

back to top ↑

Type here to search
Cloudy 10:38 AM


Rregullore e Brendshme
1 / 19
100%
APAAL
Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë
Rregullore e Brendshme
Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë
Type here to search
56°F Cloudy

**Shqip**

- ASCAL - Të dhëna statistikore për 6 mujorin e parë të vitit 2021
- ASCAL - Raporti Vjetor 2021
- ASCAL - Raporti Vjetor 2020
- ASCAL - Raporti Vjetor 2019
- ASCAL - Raporti Vjetor 2018
- Rregullore e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë"
- Modeli i Raportit të Vleresimit të Brendshem Periodik Bachelor (Standardet e reja të cilësisë 2022)
- Modeli i Raportit të Vleresimit të Brendshem Bachelor (Standardet e reja të cilësisë 2022)
- Modeli i Raportit të Vleresimit të Brendshem Periodik Diplome Profesionale (Standardet e reja të cilësisë 2022)
- Modeli i Raportit të Vleresimit të Brendshem Diplome Profesionale (Standardet e reja të cilësisë 2022)
- Modeli i Raportit të Vleresimit të Brendshem Periodik Doktorate (Standardet e reja të cilësisë 2022)
- Modeli i Raportit të Vleresimit të Brendshem Doktorate (Standardet e reja të cilësisë 2022)
- Modeli i Raportit të Vleresimit të Brendshem Periodik Master Ekzekutiv (Standardet e reja të cilësisë 2022)
- Modeli i Raportit të Vleresimit të Brendshem Master Ekzekutiv (Standardet e reja të cilësisë 2022)
- Modeli i Raportit të Vleresimit të Brendshem Periodik Master Profesional, Shkencor, Arte, (PI) (Standardet e reja të cilësisë 2022)
- Modeli i Raportit të Vleresimit të Brendshem Master Profesional, Shkencor, Arte, (PI) (Standardet e reja të cilësisë 2022)
- Modeli i Raportit të Vleresimit të Brendshem Periodik Specializime Afatgjata (Standardet e reja të cilësisë 2022)
- Modeli i Raportit të Vleresimit të Brendshem Specializime Afatgjata (Standardet e reja të cilësisë 2022)
- Modeli i Raportit të Vleresimit të Brendshem Vleresim Institucional (Standardet e reja të cilësisë 2022)
- Modeli i Raportit të Vleresimit të Brendshem Vleresim Institucional (Standardet e reja të cilësisë 2022, versioni anglisht)
- Modeli i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm - Akreditimi Institucional (shqip) 2018
- Modeli i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm - Akreditimi Institucional (anglisht) 2018
- Modeli i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm - Bachelor 2018
- Modeli i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm - Master Profesional 2018
- Modeli i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm - Master i Shkencave dhe Arteve (shqip) 2018
- Modeli i Raportit të Vlerësimit të Brendshem - Master i Shkencave dhe Arteve (anglisht) 2018
- Modeli i Raportit te Vleresimit të Brendshëm - Program Studimi me Karakter Profesional 2018
- Modeli i Raportit te Vleresimit te Brendshem - Programi i integruar i studimit "Master i shkencave" (shqip) 2018
- Modeli i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm - Programi i integruar i studimit "Master i shkencave" (anglisht) 2018
- Modeli i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm - Programi "Studimet Specializuese Afatgjata" (shqip) 2018
- Modeli i Raportit të Vlerësimit të Brendshem për akreditim periodik - Master Integruar 2018
- Modeli i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për akreditim periodik - Master Profesional 2018

Type here to search
56°F Cloudy 10:40 AM 3/27/2023

| | | |
|---|---|---|
| Rreth autoritetit | Tekstet e plota | E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar |
| Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi ASCAL | Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të ASCAL | Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat |
| Shërbimet që ofrohen nga ASCAL | Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të ASCAL | Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve |
| Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve | Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga ASCAL | Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun nga ASCAL |

- Koordinatori

  Jonida Xhaferi

- E-mail

  info@ascal.al

- Tel

  +35542256302

- Adresa

  Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë

- Orari

  E Hënë - E Enjte: 10:00 - 13:00

  E Premte: 10:00 - 12:00

- Format kërkese për informacion

Programi i Transparencës ASCAL × | Microsoft Word - lidhja_3_kerk × | +

ascal.al/media/documents/programi%20i%20transparences/Kerkese-per-informacion.pdf

IDF | Official Website

Microsoft Word - lidhja_3_kerkese_per_info_idp-1 | 1 / 1 | 100%

## KËRKESË PËR INFORMACION

| Emër Mbiemër:<br>Z./Znj. ______ | Adresa postare: ______<br>Adresa elektronike: ______<br>Nr. Tel: ______ | Data: __/__/202_<br>Nënshkrimi: |
|---|---|---|

*(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)*

| Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar |
|---|
| ______ |

| Të tjera të dhëna |
|---|
| ______ |

**Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:** ______

| Vetëm për përdorim zyrtar | | |
|---|---|---|
| Data e marrjes __/__/201_ | Numri rendor i kërkesës: | Komente: ______ |

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes

Type here to search | 56°F Cloudy | 10:43 AM 3/27/2023

Programi i Transparencës ASCAL

ascal.al/sq/programi-i-transparences/programi-transparences

OP | Official Website

KREU | RRETH NESH | BORDI I AKREDITIMIT | AKREDITIMI | SIGURIMI I CILËSISË | SONDAZHI KOMBËTAR STUDENTËVE | INFORMACIONE

| | | |
|---|---|---|
| Rreth autoritetit | Tekstet e plota | E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar |
| Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi ASCAL | Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të ASCAL | Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat |
| Shërbimet që ofrohen nga ASCAL | Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të ASCAL | Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve |
| Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve | Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga ASCAL | Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun nga ASCAL |

- Planet strategjike të punës
- Raporte monitorimi/auditimi
- Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës së ASCAL

back to top ↥

Partnerët

AFFILIATE OF ENQA

EENQA

CHE

INQAAHE

Kalendari i Veprimtarisë

« March 2023 »

| Mon | Tue | Wed | Thu | Fri | Sat | Sun |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 |
| 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 |

Kontakte

ascal

Rruga e Durrësit, Nr 219, Tiranë, AL

Kontaktet telefonike të sektorëve

Promocionit dhe Vlerësimit të Cilësisë

Type here to search

56°F Cloudy 10:43 AM 3/27/2023



# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

## QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

- Qendra e Botimeve për Diasporën nuk ka marrë asnjë kërkesë për informacion.

Not secure | qbd.gov.al/transparenca

To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.

**L I G J**
**Nr.9154, datë 6.11.2003**

**PËR ARKIVAT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

KREU I
OBJEKTI DHE PËRKUFIZIME

Neni 1

Ky ligj përcakton rregullat bazë për organizimin e funksionimin e shërbimit arkivor në Shqipëri, institucionet që kryejnë këtë shërbim, si dhe detyrimet e tyre ligjore për krijimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, si pjesë e trashëgimisë kombëtare.

Neni 2

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Arkiva" janë institucionet shtetërore ose joshtetërore të specializuara, që mbledhin, përpunojnë, administrojnë, ruajnë dhe shërbejnë pasurinë arkivore, e cila mbrohet dhe sigurohet nga shteti. Arkiva janë edhe njësitë strukturore e nënstrukturore të institucioneve të administratës shtetërore qendrore e vendore, që evidencojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në shfrytëzim dokumentet e krijuara prej tyre.

2. "Arkiv" është çdo pasuri dokumentare që ruhet prej institucioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, si dhe çdo pasuri dokumentare e krijuar ose e ruajtur prej subjekteve joshtetërore, juridike e fizike private.

3. "Autoritet publik" janë organet përfaqësuese të pushtetit qendror dhe vendor, institucionet e administratës, qendrore dhe vendore të pushteteve kushtetuese, personat juridikë dhe fizikë, në masën që ata përmbushin funksione publike ose ushtrojnë një detyrë administrative, sipas ligjeve në fuqi.

4. "Dokumente me rëndësi historike kombëtare" janë të gjitha aktet që kanë vlerë ruajtjeje të përhershme dhe shpallen si të tilla nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për shkak të rëndësisë juridiko-administrative, historike, shkencore dhe kulturore për trashëgiminë e popullit shqiptar.

5. "Dokumente" janë të gjitha aktet e krijuara nga autoritetet publike, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në funksione administrative, aktet e krijuara nga institucionet joshtetërore, si dhe subjektet juridike e fizike private, kur vlerësohen me rëndësi historike kombëtare.

6. "Fondi arkivor kombëtar" është e gjithë pasuria dokumentare, shtetërore e joshtetërore, me vlerë ruajtjeje të përhershme ose të përkohshme, në administrim të arkivave shtetërorë a private.

7. "Kërkues" është personi që ka paraqitur një kërkesë me shkrim për shërbim arkivor, e cila i është miratuar, me përjashtim të vetë personelit të brendshëm të arkivave.

8. "Komunikim" është detyrimi ligjor i arkivave shtetërorë për të vënë në dispozicion dhe për t'u shërbyer institucioneve dhe individëve dokumentet që ato ruajnë dhe përmbushja e kësaj përgjegjësie ligjore.


Not secure | qbd.gov.al/transparence/
To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.
Programi i Transparencës
Home / Programi i Transparencës
Raporti Vjetor 2022
PDF
Raporti Vjetor 2021
PDF
Raporti Vjetor 2020
PDF
Relacion i mbledhjeve me përfaqësues të shkollave shqipe në diasporë
PDF
Raporti Vjetor 2019
PDF
10:16 AM
4/18/2023

Not secure | qbd.gov.al/transparence/

To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E AUDITIMIT

Nr. 23390/3 prot.  Tiranë, më 26 2 2020

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit

**ZNJ. MIMOZA HYSI**
**DREJTOR I QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN**

*Adresa: Rruga "Vilat Gjermane" Vila nr. 6, Tiranë*

**Për dijeni: Z. PANDELI MAJKO**
**MINISTËR I SHTETIT PËR DIASPORËN**

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e kombit" nr. 1 1000, Tiranë*

Në përfundim të auditimit të kryer në institucionin Tuaj, j'u dërgojmë raportin përfundimtar të auditimit së bashku me planin e veprimit.

Bazuar në nenin 12, gërma d, të Ligjit 114 datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", pikës 3 të urdhërit të Ministrit të Financave nr. 14, datë 13.02.2017 "Për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm", brenda 30 ditësh, duhet të hartoni dhe miratoni planin e veprimit për zbatim e rekomandimeve dhe të njoftoni Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Gjithashtu mirëpresim opinionin tuaj, lidhur me punën tonë duke plotësuar formularin e vlerësimit, i cili do të na shërbente për të vlerësuar performancën tonë dhe për të identifikuar fushat ku duhet të përmirësohemi për të qenë të dobishëm për ju dhe të tjerët.

Me respekt,



qbd.gov.al/transparenca/
To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.
Hyrje
Rreth autoritetit
Kuadri ligjor rregullator
Tekstet e plota
E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar
Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP
Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AP
Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat
Shërbimet që ofrohen nga AP
Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP
Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve
Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga AP
Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga AP
Koordinator/Emri mbiemri: Orjona Domi
E-mail: info@qbd.gov.al
Nr. i gjelbër
Tel
Adresa: Rruga "Vilat Gjermane", Vila nr. 6, Tiranë, Shqipëri
Orari: E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30, E premte: 08:00 – 14:00
Format kërkese / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)
Format ankese / Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisioneri)

Not secure | qbd.gov.al/transparenca/

To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7. Learn more

PDF URDHËR "PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 413, DATË 26.07.2019, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR APLIKIMIN, PROCEDURAT, AFATET DHE DOKUMENTACION PËR T'U BËRË PJESË E REGJISTRIT SHTETËROR TË MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE E TË KULTUREËS SHQIPTARE NË DIASPORË"

PDF URDHËR NR. 1, DATË 13.01.2021 PËR MIRATIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOORDINUES TË ARSIMTARËVE TË DIASPORËS

PDF RREGULLORE E BRENDSHME PËR REVISTËN "LETËR NGA DIASPORA"

PDF URDHËR NR. 90, DATË 17.11.2020 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE STANDARDE TË PUNËS TË HARMONIZUARA, GJATË PERIUDHËS SË GJENDJES SË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19 DHE PERIUDHËS SË GJENDJES SË KOHËZGJATJES SË VITIT SHKOLLOR 2020-2021

PDF RREGULLORE E BRENDSHME PËR PËRZGJEDHJEN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM

URDHËR Nr 38, datë 12.05.2020, PËR MIRATIMIN E RREGULLORES TIP "PËR MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE GJATË GJENDJES SË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19"

10:15 AM 4/13/2023

Not secure | qbd.gov.al/transparenca/

To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.

PËR DIASPORËN

Ministria e Arsimit dhe Sportit

Kreu | Të reja | Rreth nesh | Legjislacioni | Botime | Portali digjital | KKAD | Multimedia | Kontakte

## Vendime te Keshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën

Home / Vendime të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën

PDF Vendimi nr 1, date 07.07.2022 i Keshillit Koordinues te Botimeve

PDF Vendimi nr 2, date 28.07.2022 i Keshillit Koordinues te Botimeve

PDF Vendimi nr 3, date 02.09.2022 i Keshillit Koordinues te Botimeve

PDF Vendimi nr 4, date 02.09.2022 i Keshillit Koordinues te Botimeve

PDF Vendimi nr 5, date 02.09.2022 i Keshillit Koordinues te Botimeve

10:15 AM 4/13/2023

Not secure | qbd.gov.al/transparenca/

To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7. Learn more

PËR DIASPORËN

Ministria e Arsimit dhe Sportit

Kreu | Të reja | Rreth nesh | Legjislacioni | Botime | Portali digjital | XKAD | Multimedia | Kontakte

## Vendime të Këshillit të Ministrave

Home / Vendime të Këshillit të Ministrave

PDF VENDIM Nr 82, datë 09.02.2022 "PËR PERCAKTIMIN E FUSHES SE PERGJEGJESISE SHTETERORE TE MINISTRISE SE ARSIMIT DHE SPORTIT"

PDF VENDIM Nr 448, datë 22.07.2021 "PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE DHE KATEGORIVE QË PËRFITOINË FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, PËR VITIN SHKOLLOR 2021–2022"

PDF VENDIM Nr 449, datë 22.7.2021 "PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES DHE TË KATEGORIVE, QË PËRFITOJNË FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, "TREGIME TË MOÇME SHQIPTARE" DHE REVISTA LETRARE "LETRA NGA DIASPORA"

PDF VENDIM Nr 1033, datë 16.12.2020 "PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.469, DATË 26.7.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN"

PDF VENDIM Nr 765, datë 23.9.2020 "Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën"

10:15 AM 4/18/2023

Not secure | qbd.gov.al/transparenca/
To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KUVENDI**

# LIGJ
## Nr. 16/2018
## PËR DIASPORËN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për:

a) kompetencat e autoriteteve shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën;
b) mënyrën e mbajtjes, të forcimit dhe realizimit të lidhjeve të diasporës me vendin e origjinës;
c) krijimin e Këshillit Koordinues të Diasporës;

qbd.gov.al/transparenca/

To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.

Rregullore-e-Brendshme.pdf 1 / 15 100%

QENDRA E BOTIMIT PËR SHQIPTARËT E DIASPORËS

**RREGULLORE E BRENDSHME**
**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PUNËS**
**SË QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN**

**KREU I**
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**
**Qëllimi i rregullores**

1.1 Kjo rregullore synon të përcaktojë normat e përgjithshme që rregullojnë organizimin, funksionimin, përshkrimin e strukturës, të detyrave kryesore të çdo sektori si dhe marrëdhëniet ndërmjet niveleve të ndryshme në administratën e Qendrës së Botimeve për Diasporën.

**Neni 2**
**Baza ligjore**

2.1 Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të pikës 17 të VKM nr.469, datë 26.07.2018, "Për Krijimin, Organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën"

**Neni 3**
**Përkufizime**

3.1 Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Administrata" nënkupton të gjitha strukturat dhe punonjësit e Qendrës së Botimeve për Diasporën.
b) "QBD" nënkupton Qendrën e Botimeve për Diasporën.

10:14 AM 4/18/2023

Not secure | qbd.gov.al/transparenca/
To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7. Learn more

QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Ministria e Arsimit dhe Sportit



## Struktura






RREGULLORE E BRENDSHME PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PUNËS SË QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN

10:14 AM 4/18/2023


Not secure | qbd.gov.al/transparenca/
To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.
Programi i Transparences
Hyrje
Rreth autoritetit
Kuadri ligjor rregullator
Tekstet e plota
E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar
Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP
Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AP
Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat
Shërbimet që ofrohen nga AP
Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nenligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP
Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve
Ndihma shtegërore/subvencione të dhëna nga AP
Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga AP
Struktura organizative/Organigrama
Struktura e pagave
Funksionet dhe detyrat e QBD
CV-të dhe pagat e nëpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të AP, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre
Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime
Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e QBD (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve). *Paraqitja e kërkesave dhe ankesave pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën bëhen në përputhje me parashikimet e dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë
Word 2016
10:14 AM

## Qendra e Botimeve për Diasporën





**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**
**QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN**

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

- Qendra e Botimeve për Diapsorën nuk ka marrë asnjë kërkesë për informacion.

Not secure | qbd.gov.al/transparenca/
To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.

**LIGJ**
**Nr.9154, datë 6.11.2003**

**PËR ARKIVAT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

KREU I
OBJEKTI DHE PËRKUFIZIME

Neni 1

Ky ligj përcakton rregullat bazë për organizimin e funksionimin e shërbimit arkivor në Shqipëri, institucionet që kryejnë këtë shërbim, si dhe detyrimet e tyre ligjore për krijimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, si pjesë e trashëgimisë kombëtare.

Neni 2

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Arkiva" janë institucionet shtetërore ose joshtetërore të specializuara, që mbledhin, përpunojnë, administrojnë, ruajnë dhe shërbejnë pasurinë arkivore, e cila mbrohet dhe sigurohet nga shteti. Arkiva janë edhe njësitë strukturore e nënstrukturore të institucioneve të administratës shtetërore qendrore e vendore, që evidencojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në shfrytëzim dokumentet e krijuara prej tyre.

2. "Arkiv" është çdo pasuri dokumentare që ruhet prej institucioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, si dhe çdo pasuri dokumentare e krijuar ose e marrë prej subjekteve joshtetërore, juridike e fizike private.

3. "Autoritet publik" janë organet përfaqësuese të pushtetit qendror dhe vendor; institucionet e administratës, qendrore dhe vendore të pushteteve kushtetuese, personat juridikë dhe fizikë, në masën që ata përmbushin funksione publike ose ushtrojnë një detyrë administrative, sipas ligjeve në fuqi.

4. "Dokumente me rëndësi historike kombëtare" janë të gjitha aktet që kanë vlerë ruajtjeje të përhershme dhe shpallen si të tilla nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për shkak të rëndësisë juridiko-administrative, historike, shkencore dhe kulturore për trashëgiminë e popullit shqiptar.

5. "Dokumente" janë të gjitha aktet e krijuara nga autoritetet publike, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në funksione administrative; aktet e krijuara nga institucionet joshtetërore, si dhe subjektet juridike e fizike private, kur vlerësohen me rëndësi historike kombëtare.

6. "Fondi arkivor kombëtar" është e gjithë pasuria dokumentare, shtetërore e joshtetërore, me vlerë ruajtjeje të përhershme ose të përkohshme, në administrim të arkivave shtetërore a private.

7. "Kërkues" është personi që ka paraqitur një kërkesë me shkrim për shërbim arkivor, e cila i është miratuar, me përjashtim të vetë personelit të brendshëm të arkivave.

8. "Komunikim" është detyrimi ligjor i arkivave shtetërore për të vënë në dispozicion dhe për t'u shërbyer institucioneve dhe individëve dokumentet që ato ruajnë dhe përmbushja e kësaj përgjegjësie ligjore.


Not secure | qbd.gov.al/transparenca/
To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.
Learn more
Programi i Transparencës
Home / Programi i Transparencës
Raporti Vjetor 2022
PDF
Raporti Vjetor 2021
PDF
Raporti Vjetor 2020
PDF
Relacion i mbledhjeve me përfaqësues të shkollave shqipe në diasporë
PDF
Raporti Vjetor 2019
PDF
Word 2016
10:16 AM
4/18/2023

Not secure | qbd.gov.al/transparenca/

To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E AUDITIMIT

Nr. 23390/3 prot. Tiranë, më 26.2.2020

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit

**ZNJ. MIMOZA HYSI**
**DREJTOR I QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN**

*Adresa: Rruga "Vilat Gjermane, Vila nr. 6, Tiranë*

Për dijeni: **Z. PANDELI MAJKO**
**MINISTËR I SHTETIT PËR DIASPORËN**

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e kombit" nr. 1 1000, Tiranë*

Në përfundim të auditimit të kryer në institucionin Tuaj, j'u dërgojmë raportin përfundimtar të auditimit së bashku me planin e veprimit.

Bazuar në nenin 12, gërma d, të Ligjit 114 datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", pikës 3 të urdhrit të Ministrit të Financave nr. 14, datë 13.02.2017 "Për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm", brenda 30 ditësh duhet të hartoni dhe miratoni planin e veprimit për zbatim e rekomandimeve dhe të njoftoni Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Gjithashtu mirëpresim opinionin tuaj, lidhur me punën tonë duke plotësuar formularin e vlerësimit, i cili do të na shërbente për të vlerësuar performancën tonë dhe për të identifikuar fushat ku duhet të përmirësohemi për të qenë të dobishëm për ju dhe të tjerët.

Me respekt,

10:16 AM 4/13/2023

Not secure | qbd.gov.al/transparenca/

To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.

Hyrje

| | | |
|---|---|---|
| Rreth autoritetit | Kuadri ligjor rregullator<br>Tekstet e plota | E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar |
| Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP | Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AP | Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat |
| Shërbimet që ofrohen nga AP | Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP | Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve |
| Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve | Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga AP | Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun nga AP |

- Koordinator/Emri mbiemri: Orjona Domi
- E-mail: info@qbd.gov.al
- Nr. i gjelbër
- Tel
- Adresa: Rruga "Vilat Gjermane", Vila nr. 6, Tiranë, Shqipëri
- Orari: E hënë – E enjte: 08.00 – 16.30, E premte: 08.00 – 14.00
- Format kërkese / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)
- Format ankese / Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisioneri)

10:15 AM 4/18/2023

qbd.gov.al/transparence/

To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.

URDHËR "PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 413, DATË 26.07.2019 "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR APLIKIMIN, PROCEDURAT, AFATET DHE DOKUMENTACIONI PËR T'U BËRË PJESË E REGJISTRIT SHTETËROR TË MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE E TË KULTURËS SHQIPTARE NË DIASPORË"

URDHËR NR. 1, DATË 13.01.2021 PËR MIRATIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOORDINUES TË ARSIMTARËVE TË DIASPORËS

RREGULLORE E BRENDSHME PËR REVISTËN "LETËR NGA DIASPORA"

URDHËR NR. 80, DATË 17.11.2020 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE STANDARDE TË PUNËS TË HARMONIZUARA, GJATË PERIUDHËS SË GJENDJES SË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19 DHE PERIUDHËS SË GJENDJES SË KOHËZGJATJES SË VITIT SHKOLLOR 2020-2021

RREGULLORE E BRENDSHME PËR PËRZGJEDHJEN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM

URDHËR Nr.38, datë 12.05.2020, PËR MIRATIMIN E RREGULLORES TIP "PËR MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE GJATË GJENDJES SË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19"

10:35 AM 4/13/2023

Not secure | abd.gov.al/transparence/

To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.

PËR DIASPORËN

Ministria e Arsimit dhe Sportit

Kreu | Të reja | Rreth nesh | Legjislacioni | Botime | Portali digjital | KKAD | Multimedia | Kontakte

Vendime të Keshillit Koordinues të Botimeve për Diasporen

Home / Vendime të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën

PDF Vendimi nr. 1, date 07.07.2022 i Keshillit Koordinues te Botimeve

PDF Vendimi nr. 2, date 20.07.2022 i Keshillit Koordinues te Botimeve

PDF Vendimi nr. 3, date 02.09.2022 i Keshillit Koordinues te Botimeve

PDF Vendimi nr. 4, date 02.09.2022 i Keshillit Koordinues te Botimeve

PDF Vendimi nr. 5, date 02.09.2022 i Keshillit Koordinues te Botimeve

## Vendime të Këshillit të Ministrave



PDF VENDIM Nr. 82, datë 09.02.2022 "PER PERCAKTIMIN E FUSHES SE PERGJEGJESISE SHTETERORE TE MINISTRISE SE ARSIMIT DHE SPORTIT"

PDF VENDIM Nr. 448, datë 22.07.2021 "PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE DHE KATEGORIVE QË PËRFITOJNË FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, PËR VITIN SHKOLLOR 2021 -2022"

PDF VENDIM Nr. 449, datë 22.7.2021 "PER MIRATIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES DHE TË KATEGORIVE, QË PËRFITOJNË FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN "TREGIME TË MOÇME SHQIPTARE" DHE REVISTA LETRARE "LETRA NGA DIASPORA"

PDF VENDIM Nr. 1033, datë 16.12.2020 "PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.469, DATË 26.7.2018, TË KËSHILLIT TE MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN"

PDF VENDIM Nr.765, datë 23.9.2020 "Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

# LIGJ

## Nr. 16/2018

## PËR DIASPORËN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për:

a) kompetencat e autoriteteve shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën;
b) mënyrën e mbajtjes, të forcimit dhe realizimit të lidhjeve të diasporës me vendin e origjinës;
c) krijimin e Këshillit Koordinues të Diasporës;

qbd.gov.al/transparence/

Rregullore-e-Brendshme.pdf 1 / 15

**RREGULLORE E BRENDSHME**
**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PUNËS**
**SË QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN**

**KREU I**
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**
**Qëllimi i rregullores**

1.1 Kjo rregullore synon të përcaktojë normat e përgjithshme që rregullojnë organizimin, funksionimin, përshkrimin e strukturës, të detyrave kryesore të çdo sektori si dhe marrëdhëniet ndërmjet niveleve të ndryshme në administratën e Qendrës së Botimeve për Diasporën.

**Neni 2**
**Baza ligjore**

2.1 Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të pikës 17 të VKM nr.469, datë 26.07.2018, "Për Krijimin, Organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën"

**Neni 3**
**Përkufizime**

3.1 Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Administrata" nënkupton të gjitha strukturat dhe punonjësit e Qendrës së Botimeve për Diasporën.
b) "QBD" nënkupton Qendrën e Botimeve për Diasporën.



Not secure | qbd.gov.al/transparence/
To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.
QENDRA E BOTIMEVE
PËR DIASPORËN
Ministria e Arsimit dhe Sportit
Kreu
Të reja
Rreth nesh
Legjislacioni
Botime
Portali digjital
KKAD
Multimedia
Kontakte
Struktura
KËSHILLI KOORDINUES I ARSIMTARËVE NË DIASPORË
DREJTORI
KËSHILLI KOORDINUES I ARSIMTARËVE NË DIASPORË
SEKTORI I DIGJITIMIT, KOMUNIKIMIT DHE PROJEKTEVE
SEKTORI I BOTIMIT, KOORDINIMIT DHE SHPËRNDARJES
SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
RREGULLORE E BRENDSHME PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PUNËS SË QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN
PDF
10:14 AM
4/18/2023



qbd.gov.al/transparenca/

To get future Google Chrome updates, you'll need Windows 10 or later. This computer is using Windows 7.

**Programi i Transparencës**

Hyrje

| | | |
|---|---|---|
| Rreth autoritetit | Kuadri ligjor rregullator<br>Tekstet e plota | E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar |
| Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP | Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AP | Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat |
| Shërbimet që ofrohen nga AP | Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP | Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve |
| Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve | Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga AP | Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga AP |

- Struktura organizative/Organigrama
- Struktura e pagave
- Funksionet dhe detyrat e QBD
- CV të dhe pagat e nënpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të AP, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre
- Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime
- Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e QBD (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve). *Paraqitja e kërkesave dhe ankesave pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën bëhen në përputhje me parashikimet e dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë

# Qendra e Botimeve për Diasporën

